

I KEMI BËRË SHËRBIMET MË TË AKSESUESHME



Linja 24/7 e Ndhmës për Shëndetin Mendor

Si pjesë e Udhërrëfyesit shumë-vjeçar për Shëndetin Mendor në Komunuelth, Departamenti i Shëndetit Mendor menaxhon Linjën 24/7 për Ndhmën për Shëndetin Mendor **833-773-2445** që u hap në Janar 2023. Linja e ndihmës ofron vlerësim klinik, seleksionimin dhe referimin për trajtim në kohë reale - përfshi dislokimin e ekipeve të lëvizshme të ndërhyrjes në kriza që operohen nga Qendrat Komunitare për Shëndetin Mendor që janë krijuar kohët e fundit. Asistenca është e disponueshme gjatë gjithë kohës në të gjitha komunitetet si për rezidentë që flasin anglisht edhe për ata që nuk flasin. Linja e ndihmës është falas, nuk nevojitet siguracion.

Qendrat Komunitare për Shëndetin Mendor (CBHC)

Qendrat Komunitare për Shëndetin Mendor (CBHC) janë në të gjithë Komunuelthin dhe janë të disponueshme për të ofruar trajtim me cilësi të lartë dhe në kohën e duhur të problemeve të shëndetit mendor dhe çrregullimeve të shkaktuara nga përdorimi i substancave, përfshi vizitat rutinë, vizitat urgjente dhe ndërhyrjet 24/7 komunitare për krizat si një alternativë për departamentet e emergjencave në spitale.

Shërbimet

CBHC ofrojnë shërbimet e mëposhtme, me takime personale dhe përmes linjës telefonike të shëndetit:

- Vlerësim brenda ditës dhe akses në trajtim, me takime monitoruese më pas në kohën që duhet
- Orare në mbrëmje dhe fundjavë
- Ofrim urgjent kujdesi për shëndetin mendor
- Trajtim i bazuar në prova për probleme të shëndetit mendor dhe çrregullime të shkaktuara nga përdorimi i substancave, përfshi shërbime klinike dhe shërbime të shëndetit mendor
- Qendra 24/7 në komunitet për ndërhyrje në kriza dhe ekipe të lëvizshme krizash
- Shtretër për stabilizimin e krizave

Këto Qendra u shërbejnë të gjitha moshave dhe të gjitha komuniteteve në Komunuelth.

Departamenti i Shëndetit Mendor (DMH) siguron shërbime suplementare për fëmijë, të rinj dhe të rritur në Massachusetts me nevojat më të mëdha të shëndetit mendor. Linja e Ndhmës dhe Qendrat e Shëndetit Mendor ndihmojnë DMH të përmbushë misionin e tij për të ndihmuar të gjithë rezidentët e Massachusetts të gjejnë mbështetjen e nevojshme për shëndetin mendor.

Mëso më shumë

Skano kodin QR me kamerën tënde



MASSACHUSETTS
SHËNDETI I
SJELLJES
LINJË NDIHME